



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:009631

Datë: 21.02.2020

Numri i dokumentit: 00848144

P.nr.1018/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Fatmir Krasniqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatime Bajraktari, në çështjen penale kundër të akuzuarit **U.K** nga fshati ..., Komuna e Suharekës, me mbrojtësin e tij av. N.E nga Prizreni dhe **Sh.E** nga fshati ..., Komuna e Suharekës, me mbrojtësin e tij av. L.S për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.2803/14 të datës 14.04.2017, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar gjyqësor, në prezencën e Prokurorit Themelor të Shtetit ne Prizren, Ramadan Koro, te akuzuarve, me datë **20.02.2020**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

1. U.K, nga i ati S., dhe e ëma Sh., e vajzërisë E., i lindur më datën ..., në fshatin ..., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. SH.E, nga i ati B., dhe e ëma B., e vajzërisë Kabashi, i lindur më datën ..., nga fshati ..., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa pune, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Se me daten 02.09.2014, rreth ores 04,24 min, ne Prizren, ne rr.”...” të pandehurit, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në mosprezencën e të dëmtuarit F.K, në atë mënyrë që duke i tejkaluar pengesat depërtojnë në brendi të marketit dhe nga aty marrin-vjedhin një Llaptop në vlerë rreth 330 €, monedha prej letre në vlerë rreth 180 €, cigare të ndryshme në vlerë rreth 100 €, çokollata Millka në vlerë rreth 30 €, mbushje elektronike në vlerë rreth 138 €, si dhe një fletore me shënime të borgjlinjëve që ka poseduar i dëmtuari dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit të nenit 4, 7, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74,75,76 par.1 nenpar.1.3 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së,

PRANOHET MARREVESHJA, per pranimin e fajesis ne mes te prokurorit te shtetit prane Prokuroris themelore ne Prizren, departamenti i pergjithshem penal, dhe te akuzuarve U.K ne prezencen e mbrojtjesit te tij av.N.E dhe Sh.K, ne prezencen e mbrojteses se tij av. L.S, me PP/II.nr.2803/2014 te dt.12.02.2020, per shkak te vepres penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 te KP-es.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 21, 38, 39, 40, 43, 59, 69, 70, 71, e 72 te KPK-se, dhe neni 365 te KPPK-es te akuzuarve iu shqipton:

Të akuzuarit U.K

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **500 € (pesëqindë) euro**, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë 20 euro gjobë, respektivisht 25 (njëzetë e pesë) ditë burgim, dhe

DËNIM BURGU

Në kohëzgjatje prej **1 /një/viti**.

Të akuzuarit Sh.E

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **500 € (pesëqindë) euro**, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë 20 euro gjobë, respektivisht 25 (njëzetë e pesë) ditë burgim, dhe

DËNIM BURGU

Në kohëzgjatje prej **1 /një/viti**.

Të akuzuarit obligohen ti paguajn shpenzimet e procedurës penale sado të bëhen ato në bazë të llogarise se gjykatës, në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumen secili veç e veç me nga **30 €**, në emër të kompenzimit për viktimat e krimit shumën secili veç e veç me nga **30 €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerise se këtij aktgjykimi nën kërcënim të akzektumit të dhunshëm.

I demtuari F.(I).Knga Prizreni rr.”...” ..., per realizimin e kerkeses pasurore juridike udhezohet ne kontest te rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2803/14 të datës 14.04.2017, kundër të akuzuarve U.K nga fshati ..., Komuna e Suharekës dhe Sh.E nga fshati ..., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Gjithashtu Prokuroria Themelore ne Prizren – departamenti i pergjithshem penal, sipas aktakuzes PP/II.nr.2803/14 të datës 14.04.2017, ne baze te nenit 233 te KPP-es, prokurori i shtetit dhe te akuzuarve U.K dhe Sh.K me dt. 12.02.2020, kane hyre ne marreveshje mbi pranimin e fajesis konform nenit 233 par.2 te KPP-es.

Gjykata me dt.20.02.2020 ka caktuar dhe ka mbajtur seancen lidhur me pranimin e marreveshjes mbi pranimin e fajesis, gjykata konform nenit 233 ka vleresuar marreveshjen mbi pranimin e fajesis, ka ndegjuar prokurorin e shtetit i cili ka perfaqesuar aktakuzen dhe marreveshjen mbi pranimin e fajesis, te akuzuarit U.K ne prezencen e mbrojtesit te tij av.N.E dhe Sh.K, ne prezencen e mbrojteses se tij av. L.S dhe ka vleresuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyren dhe pasojat e pranimin te fajesis, pranimi eshte bere vullnetarisht nga të akuzuarit, pas konsultimeve me mbrojtesit e tyre, ka vleresuar se nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrenguar ne asnje menyre qe ta pranojnë fajesin.

Prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzen PP/II.nr.2803/14 të datës 14.04.2017 dhe pas leximit shkurtimisht ka elaboruar marreveshjen mbi pranimin e fajesis me te cilen marreveshje te akuzuarit per vepren penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 te KP-es, ka propozuar qe te akuzuarve ti shqiptohet denimi me gjobe ne lartesi prej 500,00 € dhe me burgim ne kohezgjatje prej 1/një/ viti per secilin te akuzuar veq e veq.

Gjykata ka vleresuar se pranimi mbeshtetet ne fakte dhe prova materiale te rastit konkret e te cilat jane paraqitur ne aktakuze dhe ne provat materiale te paraqitura nga prokurori te pranuar nga i akuzuari si dhe nga deshmit tjera te paraqitura nga prokurori.

Gjykata eshte e bindur se jane permbushur te gjitha kushtet e parapara ne paragrafin 18 te nenit 233 te KPP-es, ka pranuar marreveshjen mbi pranimin e fajesis dhe pas perfundimit te ndegjimit ne seancen e shqyrtimit fillestar gjyqesor, i ka shqiptuar te akuzuarve per vepren penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 te KP-es, secilit veq e veq denimin me gjobe ne lartesi prej 500,00 euro € dhe denimin me burgim prej 1 viti, dhe duke pasur parasysh rrethanat posaqerisht lehtesuese per te akuzuarit, dhe se ate kanë pranuar fajesin me marreveshje te pershkruar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, premtimin e tyre qe ne te ardhmen nuk do te perserisin vepra te ketilla apo te ngajshme te karakterit penal e qe do te bie ndesh me kodin penal te Kosoves.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u morë në kuptim të nenit 450 dhe 453 par. 3 të KPPK-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit u more në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim qe ne ditën e sotme eshte i plotefuqishem

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1018/17 të datës 20.02.2020

Sekretarja juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.